



Prishtinë, 7.5.2010

TRASHËGIMIA n'TRYEZË

Debati 1

Hotel Unioni – Hotel Skënderbeu

RAPORT DHE KONSTATIME

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK), në kuadër të programit të tij fillojë nismën e Debateve TRASHËGIMIA n'TRYEZË. Karakteri i kësaj nisme është i natyrës informative me nivele profesionale, dhe ka për qëllim nxitjen e punës efikase të shërbimit shtetëror në relacion me ruajtje, vlerësim dhe trajtim meritore të trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislacionin e vendit, parimeve, praktikave dhe standardeve ndërkombëtare. Më dt. 6 maj 2010, në selinë e KKTK u mbajt debati i parë informues me temën Hotel Unioni - Hotel Skënderbeu në Prishtinë.

Pjesëmarrës në debat janë ftuar përfaqësues të ministrive dhe të institucioneve që përfshijnë trashëgiminë kulturore, institucionet ndërkombëtare, ekspertë të fushës, Komuna e Prishtinës, OJQ vendore dhe ndërkombëtare, mediat dhe qytetarët. Të pranishëm në takim ishin përfaqësues nga: Universiteti i Prishtinës (arkitektë), *Benetoni* (investitor dhe pronar), eksperti i mbikëqyrjes së projektit, Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Komunës së Prishtinës, Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës, ekspert të fushës, Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës dhe mediat vendore.

Takimi u drejtua nga Prof. Dr. Edi Shukriu, kryetare e KKTK, e cila fillimisht prezantoi mandatin ligjor të KKTK dhe nismën e aktivitetit TRASHËGIMIA n'TRYEZË. Duke hapur debatin lidhur me Hotel Unionin - Hotel Skënderbeu në Prishtinë, ajo theksoi se kjo ndërtesë është monument kulture në mbrojtje të shtetit dhe aktualisht i është nënshtrua rrënim. Veprimet rrënuese të këtij monumenti janë të kundërligjshme, dhe kjo gjendje bëhet më shqetësuese pasi që këto veprime ndodhin mu në zemër të kryeqytetit të Republikës së Kosovës. Kjo gjë dëshmon për nevojën e ndërmarrjeve të masave urgjente për mbrojtjen e mirëfilltë institucionale të trashëgimisë kulturore në vend. Ajo, njëherë theksoi se pas luftës në Kosovë ka pasur interesime të shumta për përvetësimin e këtij monumenti nga aktorë të lloj llojshëm dhe për interesa të ndryshme, gjithnjë duke pasur parasysh se gjendet në qendër të kryeqytetit dhe se sjellën profite ekonomike. Kështu objektivi i ruajtjes së monumentit të trashëgimisë sonë kulturore është lenë në rend dytësor, ndërsa qasja ndaj tij ka zënë dy skajshmëri, nga konservimi/restaurimi deri të rrënimi i plotë.

Pjesëmarrësit e përgëzuan iniciativën e KKTK për zhvillimin e debateve për çështje të veçanta dhe në nivel profesional. Në veçanti ata përshëndeten nisjen e debateve me çështjen e Hotel Unionit, i cili, ndonëse monument nën mbrojtje të shtetit, sot është bërë rrënojë.

Diskutuesit e parë ishin përfaqësuesit e shoqërisë ndërkombëtare *Beneton*, pronar të monumentit dhe investitor të rehabilitimit të tij. Fillimisht, ata bënë prezantimin e konceptit të projektit/planit të rehabilitimit të monumentit dhe aktiviteteve që janë zhvilluara deri më tani. Në prezantimin e tyre u theksua se projekti i rehabilitimit të monumentit zhvillohet në konceptin e ruajtjes së elementeve karakteristike të tij, dhe se aktivitetet rreth punëve planifikuese dhe sigurimit të lejes janë zhvilluar që nga viti 2006. Sipas dëshmimeve të prezantuara, punët projektuese janë zbatuar nga organizata projektuese italiane, derisa ato ndërtimore/konservuese i janë besuar organizatës italiane STEDA. Zbatimi i punimeve në monument ka filluar në vitin 2009, pasi që ndërtesa ishte përfshi nga zjarri, dhe në bazë të Planit të miratuar nga Divizioni i Trashëgimisë Kulturore të MKRS, si dhe të lejes së lëshuar nga Komuna e Prishtinës.

Gjatë proceseve të zbatimit të punimeve, në anën jug-perëndimore të ndërtesës, përkatësisht elementet të cilat janë specifikuar se duhet të restaurohen në formën e tyre ekzistuese, ka ndodhur shembja e masës së murrin në formë harkore, i cili shkaktojë dëmtime serioze konstruktive në murrin e fasadës së jashtme. Lidhur me trajtimin e dëmtimeve të shkaktuara, organizata Steda ka lajmëruar organet kompetente, dhe kompania është obliguar dhe zotuar të bëjë sanimin e tyre. Në ndërkohë është rrënuar muri i fasadës jugore dhe Komuna e Prishtinës ka bërë ndalimin e punimeve, organi i cili ka lëshuar lejen.

Në bazë të konkursit të shpallur nga Komuna e Prishtinës për zgjidhjen ideore të rregullimit të Sheshit të Pavarësisë Dr. Ibrahim Rugova, në prezantimet e *Benetonit* u ilustrua një zgjidhje ideore për mundësitë e rregullimit të Sheshit, ku sipas kriterëve të konkursit përfshihet bashkëjetesa e monumentit të rehabilituar dhe e Sheshit. Ky propozim ideor është nga pjesëmarrja në konkurs e byrosë projektuese e cila e ka elaboruar projektin e rehabilitimit të monumentit Hotel Unioni në Prishtinë. Fakti evident që monumenti sot është në gjendje teknike de-stabilizuese dhe me pamje degraduese, si dhe mbi detyrimin e njerëzimit për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në këtë rast, *Benetoni*, jo vetëm si pronar i monumentit, por edhe si donator i njohur në botë për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, shprehë gatishmëri që monumentin ta rikthejë në formën e njohur para degradimit dhe të aftësojë atë për përdorim në jetën bashkëkohore. Të arrihet ky qëllim, u nënvizua kërkesa urgjente që autoritetet e Komunës së Prishtinës duhet të lejojnë vazhdimin e punimeve, të cilat i ka ndërprerë kohë më parë.

Mrs. Shqipe Nixha, arkitekte, ligjëruese në Katedrën e Historisë së Arkitekturës, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Prishtinë, përkujtoj se lidhur me rehabilitimin e monumentit Hotel Union-Skënderbeu, në të kaluarën nga autoritetet e komunës së Prishtinës janë organizuar debate dhe nga Ministria e Kulturës janë ngritur komisione profesionale, ku janë dhënë sugjerime, udhëzime dhe mendime të mirëfillta. Në realitet, proceset janë zvarritur dhe udhëzimet profesionale nuk janë përfillur, dhe si rrjedhojë rezultatet janë shumë të dhimbshme, monumenti është lënë në mëshirë të kohës dhe trajtuar me kritere joprofesionale. Ajo përkujton se kompania *Beneton* gjithëherë ka treguar gatishmëri që ti përgjigjet kërkesave të institucioneve të Kosovës dhe kriterëve profesionale, duke theksuar se ekziston një hierarki e institucioneve kosovare që kanë kompetencat e veta. Gjithashtu, ajo theksoi se pronari ka obligime ta ruaj ndërtesën, mirëpo institucionet janë ato që është dashur të përcjellin investitorin se sa e ruan dhe si e ruan monumentin, dhe nëse nuk respektohen kriteret e mirëfillta, të ndermirën masat e nevojshme institucionale.

Inxh. Dip. Valbona Saliuka, arkitekte, punonjëse në Institutin e Monumenteve dhe Muzeut Rajonal të Prishtinës, nënvizojë rëndësinë e ruajtjes së monumentit si trashëgimi arkitekturore, dhe lidhur me projektin e rehabilitimit potencojë veçorinë e anashkalimit të kriterëve dhe sugjerimeve të institucionit saj nga autoritetet e trashëgimisë kulturore. Njëkohësisht, ajo debatohet me investitorin për detajet teknike, me akuzë se si u lejua të shkatërrohen muret kryesore të cilat është dashur që me çdo kusht të ruhen.

Përfaqësuesi nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, z. Gazmend Naka, sekretar, vuri theks se gjendja e mjerueshme në monument është pasojë e praktikës të shkeljes së procedurave administrative për lejimin dhe mbikëqyrjen e punimeve rehabilituese në monument.

Eksperti i fushës së konservimit, Mrs. Bekim Çeko, arkitekt, duke rikujtuar parimet e ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë arkitekturore, apelon për sanimin e dëmeve dhe rikthimin e monumentit në gjendjen e njohur para dëmtimit.

Konstatime

Në bazë të diskutimeve në debat konstatohet:

- Ndërtesën e Hotel Unionit në Prishtinë, në periudhën e pasluftës Institucionet e Trashëgimisë Kulturore e kanë vlerësuar dhe regjistruar si monument në Inventarin e Trashëgimisë Kulturore, dhe të njëjtin e kanë sistemuar në listën e monumenteve primare për konservim PIL, PTA
- Aktualisht, Monumenti është në gjendje degraduese, jashtë përdorimit dhe i përfshirë nga proceset shpërbërse.
- Sipas Ligjit për Trashëgimi Kulturore, ky monument i nënshtrohet mbrojtjes ligjore, prandaj gjendja e tij është e kundër ligjshme.
- Ka pasur interesime të shumta për përvetësimin e ndërtesës nga aktorë të llojllojshëm dhe për interesa të ndryshme, sidomos pas luftës në Kosovë.
- Sipas Planit Rregullues për Qendrën 1 të Prishtinës, lokacioni i monumentit vlerësohet se duhet të konservohet me destinacion kulturor dhe publik.
- Rëndësia e monumentit në mbrojtje të shtetit dhe si kujtesë historike është lenë në rend dytësor, ndërsa qasja ndaj tij ka zen dy skajshmëri, nga konservimi/restaurimi e deri të rrënimi i plotë.
- Hotel Unioni, me proceset e privatizimit nga AKM, është bërë pronë e shoqërisë aksionare ndërkombëtare *Beneton*.
- Shoqëria aksionare ndërkombëtare *Benetoni*, në cilësinë e pronarit ka marrë përsipër rehabilitimin, restaurimin dhe adaptimin e monumentit për nevoja bashkëkohore.
- Procesi i projektit të rehabilitimit ka filluar që në vitin 2006.
- Përgatitja e koncept projektit për Rehabilitim është bërë nga byro projektuese italiane, të cilët pranë Komunës së Prishtinës dhe të Institucioneve të Trashëgimisë Kulturore kanë prezantuar variante të ndryshme për rehabilitim.
- Gjatë viteve 2006/07/08, ekspertë dhe Komisione të ngritura nga Institucionet e Trashëgimisë Kulturore kanë bërë vlerësimin e planeve ideore të rehabilitimit të monumentit, kanë konstatuar që koncepti nuk është në përputhje me kriteret e restaurimit të monumenteve, dhe për këtë qëllim kanë dhënë kritere dhe udhëzime që duhet respektuar.
- Në vitin 2008, dy zyrtarë të Divizionit të Trashëgimisë Kulturore pranë MKRS miratuan një koncept variant të rehabilitimit të Monumentit, nga tria variante të propozuara.
- Në bazë të variantit të miratuar nga Divizioni i Trashëgimisë Kulturore, byroja projektuese italiane ka kompletuar projektin detal të rehabilitimit.
- Leja për zbatimin e punimeve është dhënë nga Komuna e Prishtinës.,
- Leja është dhënë në bazë të projektit në të cilin e ka dhënë pëlqimin Divizioni i Trashëgimisë Kulturore në MKRS.
- Komuna e Prishtinës është organ joligjor për dhënie të lejeve të punimeve në monumente.
- Ndërkohë, gjatë verës së kaluar, monumenti pësojë djegie të pjesshme, gjë për të cilën Policia ende nuk ka përfunduar investigimet rreth shkaqeve të djegies.
- Me rastin e zjarrit monumentit i është dëmtuar kulmi dhe nuk është ndërmarrë vendosja e kulmit mbrojtës, prandaj ndërtesa dhe struktura e saj konstruktive nga të reshurat atmosferike pësojë dëmtime serioze.
- Zbatimi i punimeve i janë besuar Kompanisë ndërtimore STEDA nga Italia, dhe punimet kanë filluar pas djegies së kulmit në vitin 2009.
- Zbatimi i punimeve nuk është mbikëqyrur nga organi i cili e ka lëshuar lejen dhe as nga autoritet e trashëgimisë kulturore, anashkalim i detyrimeve ligjore.
- Me rastin e zbatimit të punimeve, muret të cilat duhej të restaurohen në formën e tyre origjinale janë lenë të pambrojtura nga të reshurat atmosferike, gjë e cila shkaktojë shembjen e murrit të volumit harkor të monumentit si dhe destabilizojë strukturën konstruktive të murrit të fasadës në anën jugore.
- Gjendjen e krijuar nga shembja, Inxhinieri përgjegjës e ka lajmëruar pranë autoriteteve të trashëgimisë kulturore dhe Komunës së Prishtinës, të cilët edhe e konfirmuan gjendjen e shembjes së murrit harkor dhe theksuan shkallën e lartë të dëmtimit të murrit të fasadës jugore, i cili është para shembjes.
- Me qëllim të vlerësimit të shkallës së dëmtimit të murrit jugor dhe të udhëzimeve për konsolidimin e situatës së rrezikshmërisë, më kërkesën nga STEDA dhe në bazë të kërkesës dhe në pajtim me Divizionin e Trashëgimisë Kulturore/MKRS, grupi i ekspertëve ka bërë vlerësimin e dëmtimit.
- Duke e konsideruar shkallën e lartë të dëmtimit dhe rrezikshmërisë nga shembja e murrit, me qëllim respektimi të elementeve të monumentit, grupi i ekspertëve ka dhënë udhëzimet dhe metodat për konsolidimin e situatës, përkatësisht ka udhëzuar të bëhet dokumentimi teknik i gjendjes ekzistuese dhe të planifikohet

demolomi i kujdesshëm dhe ruajtja e të gjitha elementet karakteristike, si dhe muri me të gjitha elementet e tij të kthehet në gjendje funksionale stabile me formën e saj ekzakte të njohur para demolomi.

- Pëlqimi për demolimin e murit të fasadës jugore e ka dhënë Divizioni i Trashëgimisë Kulturore/ MKRS, si dhe demolomi është bërë pa respektuar metodat dhe udhëzimet e dhëna nga grupi i ekspertëve , përkatësisht pa dokumentacion teknik relevant.
- Me qëllim vlerësimi të monumentit dhe dhënie të mendimit se çka të bëhet më tej, Komuna e Prishtinës dhe MKRS, kanë ngritur komisione, të cilët kanë dhënë mendimin se edhe pse monumenti ka pësuar dëmtime të rënda, rikonstruktimi i tij sipas formës së njohur para dëmtimit është i mundur dhe i detyrueshëm.
- Investitori/pronari *Beneton* është i gatshëm të bëjë rikonstruktimin e ndërtesës sipas formës së saj të njohur para dëmtimit.
- Për momentin punimet në monument janë ndaluar nga Komuna e Prishtinës.
- Në lokacionin e afërt dhe ndërlidhur me mjedisin rrethues të monumentit, Komuna e Prishtinës disa herë radhazi ka shpall konkurs publik për projektimin e Sheshit të Pavarësisë.
- Kompania e cila e ka projektuar rehabilitimin e Monumentit, ka marrë pjesë në këtë konkurs, dhe ka dhënë zgjidhje integrale të bashkëjetesës së Sheshit dhe Hotel Unionit.
- Monumenti Hotel Unioni-Skënderbeu është njësi integrale dhe e ndërlidhur me lokacionin e përcaktuar për Sheshin e Pavarësisë.

Konkluzion i përgjithshëm dhe rekomandime

Ndërtesa ish Hotel Unioni - Hotel Skënderbeu dhe rrethina e saj në diametër prej 50 metra në cilësi të monumentit është e regjistruar në inventarin e trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës që nga viti 2001. Në bazë të Ligjit për Trashëgimi Kulturore dhe Ligjit të Planifikimit Hapësinor, ky monument i nënshtrohet mbrojtjes ligjore.

Në përputhje me parametrat ligjor për rruajtjen, mbrojtjen dhe përdorimin e trashëgimisë kulturore nga brezat e sotëm dhe të atyre pasardhës, lokacioni dhe mbetjet e ndërtesës së ish Hotel Unionit urgjent duhet rehabilituar dhe funksionalizuar në dobishmëri të zhvillimeve të qëndrueshme në vend dhe të përmirësimit të mjedisit jetësor.

Ky qëllim mund të arrihet me metodën e planifikimit në linjë të integruar, duke përdorur metodën e restaurimit, rikonstruktimit të pjesshëm të elementeve të cilat mungojnë, adaptimit të saj dhe rregullimit të mjedisit rrethues për përdorim bashkëkohor.

Procesi i planifikimit duhet të përfshijë përfaqësues nga të gjitha palët e interesit si: KKTK, Kryeministria, Ministria e Kulturës, Rinisë, Sportit, Ministria e Planifikimit Hapësinor, autoritetet e Komunës së Prishtinës, Instituti i Monumenteve në Prishtinë, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, pronari, financuesi, kompania projektuese, dhe shoqëria civile.